



MAJ 2021

NEWSLETTER



Marrëveshje bashkëpunimi

KOLEGJI AAB DHE UNIVERSITETI PUBLIK “NËNË TEREZA” NGA MAQEDONIA E VERIUT NËNSHKRUAN MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI QENDRA KOMBËTARE E MJEKËSISË SPORTIVE, PARTNER BASHKËPUNIMI I FAKULTETIT TË KULTURËS FIZIKE DHE SPORTIT



Shkëmbimi akademik Erasmus+

PROF. MAGDALENA REKSC NGA UNIVERSITETI LODZ, POLONI, LIGJËROI PËR STUDENTËT E FAKULTETIT JURIDIK



Aktivitete shkencore

U MBAJT ME SUKSES “KONFERENCA E PARË SHKENCORE ALUMNI 2021 PËR GJUHË, LETËRSI DHE DIDAKTIKË”



Ligjërata tematike

AMBASADORI I ZVICRËS, AMBASADORJA E GREQISË DHE AMBASADORI I GJERMANISË GJATË MUAJIT MAJ LIGJËRUAN NË AAB



Vullnetarizëm



DHUROHET GJAK NGA STUDENTËT DHE STAFI I AAB-SË VAZHDON FUSHATA “NJË LIBËR MË SHUMË PËR BIBLIOTEKËN TIME NË AAB”

STUDENTËT E KOMPJUTERIKËS KRIJOJNË LOJËRA KOMPJUTERIKE NË JAVA

5 Maj 2021

Në kuadër të lëndës “Programimi i lojërave kompjuterike”, studentët e Fakultetit të Shkencave Kompjuterike kanë krijuar lojëra kompjuterike, të cilat janë dizajnuar në 2D dhe janë programuar në JAVA.

Studentët Mimoza Bahtiri, Behar Deskaj dhe Eron Bylykbashi kanë krijuar lojën BrickBreaker.



Loja Garuesit, është krijuar nga studentët Zenel Bobi dhe Taulant Fondaj. Edhe kjo lojë është e programuar në JAVA.

Pong është loja e krijuar në 2D, e programuar në JAVA nga studenti Leurit Rama.

Ndërsa studenti Artan Mehmeti, ka krijuar lojën Tic-Tac-Toe, e cila është një lojë 2D për dy persona e programuar në JAVA. Luhet në një matricë 3×3 katrorë.

FAKULTETI I KULTURËS FIZIKE DHE SPORTIT NËNSHKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME QENDRËN KOMBËTARE TË MJEKËSISË SPORTIVE

7 Maj 2021

Fakulteti i Kulturës Fizike dhe Sportit ka nënshkruar marrëveshjen bashkëpunimi me Qendrën Kombëtare të Mjekësisë Sportive, që është institucion publik shëndetësor i cili bënë pjesë në Shërbimin Spitalor Klinik Universitar të Kosovës.

Përmes kësaj marrëveshjeje synohet që studentëve të Kolegjit AAB, t' u ofrohet mundësia për realizimin e pjesës praktike të studimeve dhe zhvillimin e njohurive të reja praktike, në kuadër të programit master Fitnesi dhe Nutricioni.

Marrëveshja u nënshkrua nga Dekani i Fakultetit të Kulturës Fizike dhe Sportit, Prof.Asoc. Dr. Fatmir Pireva, dhe drejtori i Qendrës Kombëtare të Mjekësisë Sportive, Dr. Afrim Shabani.



QKMS si qendër referente e mjekësisë së sportit, ofron shërbime shëndetësore për të gjithë sportistët dhe pacientët e referuar aty. Kjo qendër kryen edhe hulumtime kërkimore shkencore, statistikore dhe përgatit programin e masave të kujdesit shëndetësor nga fushë veprimtaria e vet që studentëve do t'ju ndihmojë në zhvillimin e tyre profesional.

AMBASADORI KOLLY: “ËSHTË EDHE NË INTERESIN E ZVICRËS TË KEMI MARRËDHËNIE TË NGUSHTA ME KOSOVËN”

8 Maj 2021

Kanë vazhduar ligjëratat speciale me ambasadorë të akredituar në vendin tonë, për studentët e nivelit master të Fakultetit të Administratës Publike, në kuadër të moduleve të Historisë së Diplomacisë dhe të Politikës së Jashtme.



Ishte Ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Sh.T. Thomas Kolly, i ftuari i radhës i cili ndau me studentët tanë historinë e shtetit zviceran, por edhe qëndrimet e Zvicrës për politikën e jashtme.

Duke folur për raportet diplomatike të Zvicrës dhe Kosovës, ambasadori zviceran Kolly theksoi se Zvicra ka një marrëdhënie shumë të veçantë me Kosovën, gjë që ka ndikuar që Zvicra të ishte një nga vendet e para që njohu Kosovën si një vend të pavarur.

“Është edhe në interesin tonë (të Zvicrës) që ta kemi këtë bashkëpunim. Ky nuk është një proces i një anshëm, shkon në të dy anët, sepse edhe ne si Zvicër kemi benefitet tona, kështu që është në interesin tonë që të kemi një marrëdhënie të ngushtë me Kosovën dhe ne jemi shumë të lumtur për këtë”, theksoi Kolly.



Ai foli edhe për sukseset dhe arritjet e shqiptarëve të Kosovës në Zvicër, ku theksoi se në të kaluarën kishte interesim të madh për të emigruar për shkak të kushteve ekonomike. Ndërsa sot, lidhjen e Zvicrës me Kosovën mund ta lidhim edhe me Ylfete Fanaj, që është shqiptare nga Kosova dhe është Kryetare e Këshillit të Kantonit të Luzernit.

Ambasadori i Zvicrës në Kosovë, Thomas Kolly, para ligjëratës me studentë u prit nga prorektorët Shemsedin Vehapi e Venera Lllunji, të cilët e njoftuan për historikun, zhvillimin dhe synimet e Kolegjit AAB.

STUDENTËT DHE STAFI I AAB-SË DHURUAN GJAK NË AKSIONIN PËR SHËNIMIN E DITËS NDËRKOMBËTARE TË INFERMIERISË

14 Maj 2021

Sikur edhe çdo vit tjetër, Fakulteti i Infermierisë i Kolegjit AAB shënoi 12 Majin, Ditën Ndërkombëtare të Infermierisë.

Në bashkëpunim me Qendrën Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut, u organizua Dita e Dhurimit Vullnetar të Gjakut. Kësaj thirrje iu përgjigjën dhjetëra studentë e staf i Kolegjit AAB, duke pasur parasysh edhe nevojën për doza të gjakut në qendrat spitalore.



Për shkak të situatës me pandeminë Covid-19, aktivitetet për shënimin e kësaj dite këtë vit ishin simbolike, megjithatë roli i infermierit u vlerësua jashtëzakonisht në veçanti duke pasur parasysh situatën në të cilën është gjendur globi.

Edhe përfaqësuesit e Qendrës Kombëtare të Kosovës për Transfuzionin e Gjakut u shprehën falënderues për këtë kontribut, duke mos harruar që kjo qendër kishte shpallur Kolegjin AAB si dhuruesin më të madh të gjakut nga të gjitha institucionet arsimore në vend.



AMBASADORJA ALIFERI: GREQIA MBËSHTET FUQISHËM LIBERALIZIMIN E VIZAVE PËR KOSOVARËT

15 Maj 2021

Ligjëratorën në temën “Politika e jashtme e Greqisë”, shefja e Zyrës Diplomatike të Greqisë në Kosovë, Ambasadorja Chryssoula Aliferi, e ka nisur me historinë e Greqisë dhe të kombit grek, historinë e formimit të kombeve të Ballkanit dhe zhvillimet historike të këtij territori.

Ambasadorja Aliferi, ka folur gjithashtu për sistemin parlamentar të Greqisë, për të cilin ka thënë se është i njëjtë me sistemin e Kosovës.



Duke folur për njohjen e Kosovës nga Greqia, ambasadorja Aliferi tha se Greqia nuk e ka njohur ende Kosovën, porse kujdesen për Kosovën, madje disa herë edhe më shumë se vendet që na kanë njohur.

“Ne nuk ju njohim por kujdesemi, kujdesemi shumë dhe kujdesemi ndonjëherë më shumë sesa disa njohës. Faleminderit për zyrën pasi jam ambasador në vend. Greqia ka qenë këtu përmes NATO, KFOR, Eulex. Ne kishim njerëz tanë edhe në UNMIK. Ne e kemi ndihmuar Kosovën të hyjë në organizata specifike ndërkombëtare. Ne njohim pasaportat, lëshojmë viza. Ne duam të higen vizat. Duhet të presim vendimet e partnerëve tanë. Por, ne favorizojmë fuqimisht liberalizimin e vizave për Kosovën”, tha Aliferi.



Në fund të ligjëratorës, në sesionin e diskutimit me studentët, diplomatja e karrierës Chryssoula Aliferi, ka folur edhe për dialogun Kosovë-Serbi, për të cilin ka thënë se mbështet një dialog nën ndërmjetësimin e BE-së, i cili do të sillte një zgjidhje përfundimtare: “Rezultatet e mira do të hapin rrugën për shumë gjëra. Për kompromise, mos na pyetni neve, sepse ne kemi bërë kompromiset tona vite më parë. Jeta vazhdon, por ju duhet të mendoni për të ardhmen tuaj dhe të ardhmen e fëmijëve tuaj. Lërinë udhëheqësit tuaj të jenë bujarë me anën tjetër.”



Ligjërata me ambasadoren greke u organizua në kuadër të moduleve “Politika e jashtme” dhe “Historia e diplomacisë”, të cilat ligjërohen nga prof. Nexhmedin Spahiu në kuadër të Fakultetit të Administratës Publike.

FAKULTETI I PSIKOLOGJISË SHËNOI JAVËN E VETËDIJESIMIT PËR SHËNDETIN MENDOR

15 Maj 2021

Në kuadër të javës për vetëdijesimin për shëndetin mendor, në organizim të Fakultetit të Psikologjisë të Kolegjit AAB dhe Klinikës “Empatia”, në Kolegjin AAB u mbajt Tryezë Diskutimi me profesionistë të fushës, në temën “Të kuptojmë shëndetin mendor / Reflektim në kohë pandemie”



Dekani i Fakultetit të Psikologjisë, Prof. Naim Telaku, në hapje të kësaj tryeze, përmendi disa nga shifrat më domethënëse sa i përket shëndetit mendor, të publikuara nga OBSH.

Sipas Telakut, fusha e shëndetit mendor, megjithëse bukur shumë e injoruar, sipas statistikave të ndryshme, është njëra prej fushave me problematikën më të madhe në nivel global.

Ai bëri të ditur se sipas OBSH-së, rreth 10% e popullatës së botës është e prekur nga sëmundjet mendore, ndërkohë që ky numër në vendet e varfëra mund të shkojë deri në 20%. Prej tyre janë rreth 264 milionë njerëz të cilët vuajnë nga depresioni, nga çrregullimet bipolare rreth 45 milionë, nga skizofrenia rreth 20 milionë njerëz, derisa demencat kanë prekur rreth 50 milionë njerëz në glob.



Problemet e shëndetit mendor, janë shkak edhe i vetëvrasjeve, duke dhënë një statistikë shqetësuese në veçanti të moshat 15-29 vjeç, ku vetëvrasja është shkaktari i dytë më i madh i vdekjeve në nivel global.

Te kjo grup moshë, në çdo 40 sekonda, një i ri bën vetëvrasje në botë.

Një problem tjetër që e theksoi dekani Telaku është edhe niveli i ulët i vetëdijesimit për natyrën e problemeve të shëndetit mendor edhe tek popullata e përgjithshme por edhe te institucionet e ndryshme.



Ai nënvizoi gjithashtu edhe një rritje të dukshme të paraqitjes së ankthit te popullsia, ku sipas tij, për shkak të pandemisë Covid-19, niveli i ankthit është rritur nga 30-50%.

Në këtë tryezë, e ftuar ishte edhe psikologja Shqipe Ukshini, nga QKUK, e cila tha se rritja e problemeve të shëndetit mendor lidhet proporcionalisht edhe me rritjen dhe mbingarkesën e vendbanimeve urbane.

Ndërsa, psikologu Fitim Uka, nga Klinika “Empatia” tha se për dallim nga periudha e para një dekade ka një perspektivë në trajtimin e këtyre sëmundjeve, sepse sot njerëzit flasin më haptas për shëndetin mendor dhe shqetësimet e tyre.

Në këtë tryezë diskutimi mori pjesë edhe psikologja Shkurtë Bajgora, nga linja e ndihmës psikologjike “Mbështetu”, që ka për qëllim ndihmën e parë psikologjike për qytetarët e shqetësuar. Ajo theksoi se në këtë linjë paraqiten raste të ankthit, sulmeve të panikut, shqetësime personale në familje apo me shoqëri.

STUDENTËT E PROGRAMIT PËRKUJDESJA DHE MIRËQENIA E FËMIJËVE VIZITUAN QENDRAT BURIMORE PËR MËSIM DHE KËSHILLIM NË PRIZREN

21 Maj 2021

Një grup i studentëve të Fakultetit të Shkencave Sociale, programi Përkujdesja dhe Mirëqenia e Fëmijëve, së bashku me profesoreshën Dr.Sc. Sevim Mustafa, vizituan Qendrat Burimore për Mësim dhe Këshillim “Lef Nosi” dhe “Nënë Tereza” në Prizren.

Ata u informuan detajisht se si zhvillohet procesi mësimor tek fëmijët me dëmtime në dëgjim dhe në të folur përmes gjuhës së shenjave dhe ndihmës së interpretuesit të gjuhës së shenjave.



Në këto qendra mësimi zhvillohet njëjtë si në gjithë shkollat e Kosovës duke u bazuar në dokumentin e kurrikulës, por duke u përshtatur në nevojat individuale të secilit nxënës dhe punohet me plan individual dhe sipas fushave të aktiviteteve për secilin fëmijë i cili rishikohet dy herë në vit.

Studentët mësuhan konkretisht se si hartohet një PIA (Plani Individual Arsimor) për secilin nxënës në bazë të nevojave individuale të nxënësit, dhe diskutuan po ashtu edhe rreth fushave të aktiviteteve që hartohen në bazë të nevojave të tyre individuale.



Këto vizita u vlerësuan si shumë e dobishme për studentët, ngaqë ata morën informacione të shumta për punën e realizuar me shumë përkushtim nga ana e personelit me qëllim që fëmijët të arrijnë sukses në të gjitha fushat brenda qendrës dhe inkuadrimin e nxënësve në shkollat e rregullta.


CILA ËSHTË MËNYRA MË E MIRË PËR TA MËSUAR GJUHËN ANGLEZE, PËRMES STUDIMIT APO PËRVETËSIMIT?

22 Maj 2021

Në kuadër të aktiviteteve të njëpasnjëshme të Klubit të Debatit të studentëve të Fakultetit të Gjuhës Angleze, debati i mbajtur së fundi shtjelloi temën e të nxënit të gjuhës angleze.

Në këtë aktivitet debutues morën pjesë dy ekipe studentësh “Debatuesit” dhe “Shkencëtarët”, ndërsa në cilësinë e jurisë vlerësuese ishin profesorët Xhavit Rexhaj, Mirvan Xhemajli, Hysen Kasumi dhe dekanja Aida Alla.

Pjesëmarrësit debatuan dhe dhanë gjykimet e tyre mbi tema të ndryshme sa i përket kësaj çështjeje, si: A mund të mësohet gramatika e një gjuhe përmes përvetësimit? Si ka mundësi që fëmijët të mësojnë gjuhën e nënës pa pasur nevojë për mbështetje në libra? Cila është mënyra më efektive dhe e shpejtë për të mësuar gjuhën angleze?, etj..



Debati zgjati 90 minuta, ndërsa në fund juria dha komentet dhe vlerësimet e tyre duke e cilësuar ekipin pohues si “Debatuesit” për aftësinë e tyre për të debatuar, dhe ekipin mohues si “Shkencëtarët” për faktin se përdorën shumë referenca dhe të dhëna statistikore për t’i mbështetur argumentet e tyre.

Në fund juria vendosi për një rezultat të barabartë në mes skuadrave.

STUDENTËT E FAKULTETI EKONOMIK ZHVILLUAN PUNËTORI PËR MENAXHIMIN E FURNIZIMIT ZINXHIROR

24 Maj 2021

Nën udhëheqjen e prof.ass.dr. Fëllanzë Pula, studentët e Fakultetit Ekonomik morën pjesë në punëtorinë “Menaxhimi i Furnizimit Zinxhiror”.

Në këtë punëtori, morën pjesë tre grupe me gjithsej 30 studentë.

Qëllimi i organizimit të këtij aktiviteti ishte që studentët të avancojnë njohuritë e tyre me metodat bashkëkohore të punës, duke nxitë kreativitetin e studentëve në zgjidhjen e sfidave dhe problematikave që do t’i hasin në vendet e tyre të punës.



Studentët të ndarë në grupe bënë punime të ndryshme për Menaxhimin e Furnizimit Zinxhiror, si: menaxhimi i depos, transporti dhe e ardhmja e transportit dhe shpërndarja/distribuiimi si pjesë e Menaxhimit të Furnizimit Zinxhiror.



Përfaqësuesit të grupeve ishin: Donjeta Morina, Driton Rrahmani dhe Labinot Krasniqi, ndërsa punëtoria u përmbyll me prezantimin e punimeve para dekanatit, mësimeve dhe kolegëve të grupit.





PROFESORESHA MAGDALENA REKŚĆ NGA UNIVERSITETI I LODZ, POLONI, MBAJTI LIGJËRATA NË AAB NË KUADËR TË PROGRAMIT PËR SHKËMBIM ERASMUS+

25 Maj 2021

Në kuadër të Programit Erasmus+ për shkëmbimin e stafit akademik, dhe marrëveshjes për bashkëpunim me Universitetin e Lodz nga Polonia, në Kolegjin AAB qëndroi për vizitë profesoresha Magdalena Rekść.

dr hab. Magdalena Rekść në cilësinë e profesorit vizitor gjatë qëndrimit njëjavor në Kolegjin AAB do të zhvillojë një seri ligjëratash me studentët e vitit të tretë dhe të katërt të Fakultetit Juridik.



Rekść është pjesë e Departamentit të Metodologjisë së Kërkimit Politik dhe Parashikimit Politik të Universitetit të Lodz (WSMiP), dhe sekretare në Qendrën Shkencore dhe Kërkimore të Universitetit të Lodz "Ballkani në fund të shekullit 20/21".

Ajo ka botuar dhjetëra artikuj shkencorë dhe ka marrë pjesë në konferenca të rëndësishme shkencore. Është anëtare e Komitetit për Studime Ballkanike të Akademisë Polake të Shencave dhe anëtare e Shoqatës Shqiptaro-Polake dhe Kosovaro-Polake.

EDHE ISOFT PJESË E PARTNERËVE TË FAKULTETIT TË SHKENCAVE KOMPJUTERIKE NGA INDUSTRIA E TEKNOLOGJISË

26 Maj 2021

Fakulteti i Shkencave Kompjuterike i Kolegjit AAB dhe “iSoft SHPK” nga Prishtina, nënshkruan marrëveshje bashkëpunimi.

Kjo marrëveshje e bashkëpunimit e cila ka për qëllim realizimin e punës praktike të studentëve të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB në “iSoft SHPK”, u nënshkrua nga Dekani i Fakultetit të Shkencave Kompjuterike të Kolegjit AAB, prof. Jusuf Qarkaxhija dhe Drejtori Menaxhues i “iSoft SHPK”, z.Tuna Bütüçi.



Marrëveshja në fjalë ngrit numrin e partnerëve nga industria e teknologjisë të Fakultetit të Shkencave Kompjuterike edhe më shumë, duke mundësuar kështu sigurimin e tregut të punës jo vetëm për të diplomuarit por edhe për studentët aktualë.

Këtë e vërteton edhe fakti se tashmë pjesë e “iSoft SHPK” janë edhe dy studentë të AAB-së, ndërsa ky numër pritet të rritet edhe më tej në të ardhmen.



KOLEGJI AAB NËNŠKROI MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI ME UNIVERSITETIN PUBLIK “NËNË TEREZA” NGA MAQEDONIA E VERIUT

27 Maj 2021



Kolegjit AAB iu shtua edhe një partner bashkëpunimi nga Maqedonia e Veriut, me nënshkrimin e memorandumit për bashkëpunim me Universitetin Publik “Nënë Tereza” nga Shkupi.

Në ceremoninë e nënshkrimit të marrëveshjes morën pjesë udhëheqësit më të lartë akademikë të dy institucioneve respektive.

Marrëveshja u nënshkrua nga rektori Bujar Demjaha, në emër të Kolegjit AAB dhe prof.dr. Rizvan Sulejmani, prorektor për marrëdhënie ndërkombëtare në Universitetin “Nënë Tereza”.



Palët janë zotuar që përmes kësaj marrëveshjeje do të ngritin bashkëpunimin e tyre në të gjitha fushat universitare, duke përfshirë shkëmbimin e përvojave të stafit akademik e administrativ, shkëmbimin e studentëve në cikle të ndryshme studimi në periudha semestrale ose periudha të praktikave, organizimin e konferencave shkencore, seminareve, tryezave, aplikimin e përbashkët në fonde vendore e ndërkombëtare për projekte në fushën e arsimit të lartë, etj..

UNT është universiteti i parë publik në gjuhën shqipe në kryeqytetin e Maqedonisë së Veriut, ndërsa në kuadër të tij funksionojnë 5 fakultete me 14 programe studimi.

TË DIPLOMUARIT E KOLEGJIT AAB TË PUNËSUAR NË GJERMANI, NDANË PËRVOJAT E PUNËSMIT TË TYRE ME STUDENTËT E INFERMIERISË

28 Maj 2021

Nën organizimin e Fakultetit të Infermierisë dhe Programit për Karrierë dhe Punësim, në Qendrën Mediale të Kolegjit AAB u mbajt një takim virtual me të diplomuar të këtij programi në AAB, tashmë profesionistë shëndetësorë, të punësuar në klinika prestigjioze gjermane. Ish studentët Bleona Zabërgja, Qëndresa Seferi dhe Kushtrim Haliti, të cilat kanë filluar punën në Gjermani përmes Programit për Karrierë dhe Punësim, ndanë përvojat e tyre rreth punësimit në Gjermani, me studentët aktualë në Fakultetin e Infermierisë.



Ndër të tjera, Bleona, Qëndresa dhe Kushtrimi i informuan studentët për procedurat të cilat i kanë ndjekur për të plotësuar kushtet për fillimin e punës në Gjermani dhe për mikpritjen që iu është bërë nga stafi i Klinikës.



Takime të tilla virtuale me ish-studentët tjerë të Programit që po ashtu kanë filluar dhe pritet të fillojnë punën në Gjermani, do të mbahen në vazhdimësi, në mënyrë që studentët e programit por edhe studentët e Infermierisë të Kolegjit AAB, të cilët synojnë të mësojnë gjuhën gjermane dhe të fitojnë një kontratë pune në klinika prestigjioze gjermane përmes Programit për Karrierë dhe Punësim, të informohen vazhdimisht me përvojat e ish-studentëve tanë nga vendet e tyre të Punës në Gjermani.

AMBASADORI GJERMAN: PUNONI ME FRANCËN DHE HOLANDËN TË NDRYSHOJNË QËNDRIMIN PËR LIBERALIZIM TË VIZAVE PËR KOSOVARËT

29 Maj 2021

Në ligjëratën e radhës tematike për diplomacinë, për studentët e Fakultetit të Administratës Publike në Kolegjin AAB, u fol për diplomacinë gjermane, ku i ftuar ishte ambasadori gjerman në Kosovë, Sh.T. Joern Rohde.

Duke qenë njëri nga vendet më me ndikim në Bashkimin Evropian, interesi i studentëve ishte shumë më i shprehur në qëndrimet e Gjermanisë për zhvillimet politike në vend, rajon dhe më gjërë.

Kësisoj, Ambasadori i Gjermanisë në Prishtinë, Joern Rohde, u shpreh se nuk sheh alternativë tjetër për Kosovën përpos bisedimeve me Serbinë dhe rikonfirmoi mbështetjen e Gjermanisë në këtë proces. Ai madje tha se BE dhe SHBA janë në një linjë të njëjtë sa i përket dialogut Kosovë-Serbi dhe se këtë e dëshmon vizita e përbashkët e dy personaliteteve të rëndësishme në Kosovë, Miroslav Lajçak dhe Mathew Palmer.



Krahas dialogut, ambasadori Rohde tha se Gjermania ka ofruar ndihmën e plotë për Kosovën edhe përmes Procesit të Berlinit, të nisur nga kancelarja Angela Merkel.

“Samiti i radhës i Procesit të Berlinit, është paraparë të mbahet në fillim të korrikut në Berlin, me të gjitha gjashtë shtetet e Ballkanit Perëndimor...” tha Rohde, duke nënvizuar lëvizjen e lirë në vendet e Ballkanit Perëndimor.



Diplomati gjerman i quajti të pavërteta deklaratat e opozitës kosovare, se marrëveshjet eventuale në këtë proces janë “krijim i Jugosllavisë e Re”. “Për ne Procesi i Berlinit i jep Kosovës një platformë për të qenë në mesin e të barabartëve në këtë rajon dhe të mos trajtohet ndryshe. Ne shpresojmë që kjo të jetë sukses”, tha ai.



Ndërsa duke folur për mos-liberalizimin e vizave për kosovarët, një çështje kjo që më së shumti i afekton studentët që synojnë studimet jashtë vendit, ambasadori Rohde e quajti të padrejtë këtë qëndrim. Ai kërkoi nga Kosova që të punojë afër me Francën dhe Holandën, për t'ua ndryshuar qëndrimin lidhur me këtë temë.

STUDENTËT E NIVELIT MASTER DISKUTUAN PËR SFIDAT E FURNIZIMIT ZINXHIROR GJATË PANDEMISË COVID-19 ME BIZNESMENIN RAMIZ KELMENDI

28 Maj 2021

Në kuadër të modulit “Menaxhimi i furnizimit zinxhiror” në programin Marketing dhe Menaxhim Biznesi, niveli master, studentët e këtij programi patën mundësinë të bashkëbisedojnë me z.Ramiz Kelmendi, pronar i kompanisë Elkos Group – ETC, në cilësinë e folësit mysafir.

Në këtë takim me studentët, biznesmeni i njohur foli për sfidat e udhëheqjes së një biznesi, prodhuesi në Kosovë, përparësitë dhe mangësitë e udhëheqjes, kalimin e menaxhimit nga mënyra tradicionale në atë dixhitale nga viti 1989 deri në vitin 2021.



Po ashtu një nga temat e pashmangshme në këtë bashkëbisedim ishte edhe pandemia Covid-19 dhe sfidat e kompanive kosovare në menaxhimin e funizimit zinxhiror gjatë pandemisë.

Z.Kelmendi në këtë bashkëbisedim interaktiv shpalosi shumë sfida, problematika e shumë eksperiencë me të cilat janë ballafaquar ndër vite dhe gjatë pandemisë si ato: të transporteve, furnizimeve, porositve dhe të shitjeve.

Kompania ELKOS GROUP – ETC është distributor dhe përfaqësues gjeneral për Kosovë, për brendet më të njohura ndërkombëtare, si dhe përkrahësi më i madh i prodhuesve vendor në zinxhirin e marketeve ETC.




U MBAJT ME SUKSES “KONFERENCA E PARË SHKENCORE ALUMNI 2021 PËR GJUHË, LETËRSI DHE DIDAKTIKË”

28 Maj 2021

Fakulteti i Gjuhës Angleze në Kolegjin AAB mbajti “Konferencën e Parë Shkencore Alumni 2021 për Gjuhësi, Letërsi dhe Didaktikë”.

Ky aktivitet shënoi themelimin e një rrjeti të përbashkët midis të diplomuarve në Programin Master të Fakultetit të Gjuhës Angleze me profesorët e këtij fakulteti.



Në fjalën e tij përshëndetëse, Rektori i Kolegjit AAB, profesor Bujar Demjaha u shpreh se ALUMNI është një komunitet i rëndësishëm pasi janë të diplomuarit ata të cilët reflektojnë suksesin e Kolegjit me punën e përditshme dhe projektet e të diplomuarve në Kosovë dhe jashtë saj. Rektori Demjaha u shpreh se ky aktivitet duhet të kthehet në një traditë të përvitshme, edhe në nivel Kolegji.

Ndërsa dekanja e Fakultetit të Gjuhës Angleze, profesor Aida Alla shprehu vlerësimin e saj për pjesëmarrësit si edhe falënderoi ish-mentorët për bashkëpunimin e ngushtë me kandidatet e tyre. Ajo tha se studimet e tyre 5 vjeçare në Kolegjin AAB u kanë hapur dyert për sukseset e radhës.



Konferenca kishte për qëllim kryesor prezantimin e gjetjeve të hulumtuesve të rinj në fushën e gjuhësisë, letërsisë dhe didaktikës, të cilat padyshim janë të rëndësishme në të mësuarit, studimin dhe zhvillimin e një gjuhe.



Konferenca mirëpriti rreth 30 hulumtues të cilët dhanë prezantimet e tyre në gjuhën angleze dhe shqipe. Profesorët e Kolegjit AAB gjithashtu morën pjesë në diskutime, duke parashtruar pyetje dhe duke dhënë komente në mënyrë të vazhdueshme. Konferenca rezultoi e suksesshme dhe pjesëmarrësve iu ndanë certifikata nga mentorët e tyre respektivë.




PO VAZHDON FUSHATA “NJË LIBËR MË SHUMË PËR BIBLIOTEKËN TIME NË AAB”

31 maj 2021

Fushata “Një libër më shumë për bibliotekën time në AAB”, e iniciuar nga Biblioteka Universitare AAB, po vazhdon edhe më tutje me qëllimin për të nxitur studentët dhe stafin e Kolegjit AAB që të ndajnë me të tjerët librat që konsiderojnë se mund t’i kontribuojnë rritjes së fondit të Bibliotekës.

Në vazhden e zhvillimit të fushatës, drejtori i Bibliotekës, Urim Sallauka, ishte i ftuar në emisionin Studio A në ATV, ku foli për veprimtarinë e Bibliotekës dhe kontribuesit e deritanishëm.



NJË LIBËR MË SHUMË PËR BIBLIOTEKËN TIME NË AAB



Ai u bëri thirrje edhe njëherë të gjithë studentëve dhe stafit që ta përkrahin këtë iniciativë e cila do të zgjasë deri në muajin shtator kur pritet të mbahet edicioni i radhës i Panairit Vjeshtor të Librit AAB.

Të gjithë ata që dëshirojnë të mbështesin këtë nismë, librat e dhuruara mund t’i sjellin në cilëndo nga bibliotekat e AAB-së, në Prishtinë, Ferizaj apo Gjakovë.

TRAJNIMET E MUAJIT MAJ

"Shëndeti publik, kujdesi infermieror dhe procesi pandemik Covid-19"

"Procesi i menaxhimit të pandemisë të grupmoshat e ndryshme"

IMPROVING NURSING EDUCATION AND PRACTICE IN COVID-19 PANDEMIC PROCESS

"EVP NURSING II"

JUNE 03

12:30 PM

DIFFERENT AGE GROUPS AND MANAGEMENT IN PANDEMIC PROCESS

- Active participants (8 accreditation points)
- Passive participants (6 accreditation points)

NJOFTIME

Fillon paraqitja e provimeve të afatit të qershorit 2020/21

Kolegji AAB
CILËSI. LIDERSHIP. SUKSESI

aab-edu.net

AFATI I PROVIMEVE QERSHOR 2020/2021

PARAQITJA
20 maj 2021 - 07 qershor 2021

PROVIMET
7 qershor 2021 - 4 korrik 2021

AFATI I PROVIMEVE TË QERSHORIT ËSHTË AFAT I VLEFSHEM PËR TË GJITHË STUDENTËT. PARAQITJA MUND TË BEHET EDHE ONLINE PËRMES SHERBIMIT E-SERVICE.

WORKSHOP ONLINE

"Si të krijojmë një kriptovalutë dhe çdo gjë mbi përdorimin e tyre"

WORKSHOP ONLINE

Si funksionojnë
KRYPTOVALUTAT

How Does Cryptocurrency Work

E HËNË, 17 MAJ 2021
ORA 20:00

Apliko përmes: fshk.workshop@universitetiaab.com

Zgjatet afati i fotografimit të absolventëve të kampusit të Prishtinës 2020/21, deri më 14 qershor 2021

Kolegji AAB

FOTOGRAFIMI I ABSOLVENTËVE 2020/21

ZGJATET AFATI I FOTOGRAFIMIT DERI MË 14 qershor 2021

SË SHPEJTI NË AAB

Konferenca e II-të Alumni, e Fakultetit Ekonomik

"Ndikimi i masave anti-Covid 19 në ekonominë e Republikës së Kosovës"

KUJTIMET TUAJA TË STUDIMEVE DO T' I MEMORIZOJMË NË:

NJË FOTO
30x65cm

NJË FOTO ME NGJYRA (COLOR)
10x15cm

NJË FOTO BARDH E ZI
10x15cm

KATËR(4) FOTO
4x6cm